

Emërtimi i programit të studimit: **BACHELOR NË BIOLOGJI-KIMI**

|                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emërtimi akademik i studimit</b>            | <b>Diplomë Universitare Bachelor në Biologji - Kimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Statusi i Akreditimit të programit të studimit | AKREDITUAR me Vendim nr.44, datë 28.02.2025                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Cikli i studimit                               | Cikli i parë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Emri dhe statusi i institucionit               | Universiteti “Eqrem Çabej” ,Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Institucion Publik i Akredituar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime        | Shqip                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit    | 3 (tre) vite                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Forma e studimit                               | Me kohë të plotë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Kushtet e pranimit                             | <p><b>a.</b>Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p><b>b.</b> Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p><b>c.</b>Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (<b>portali U-albania</b>).</p> <p><i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i></p> |

## OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit Bachelor në Biologji -Kimi është marja e njohurive të plota dhe të thella në fushën e Biologjisë dhe Kimisë për përgatitjen e specilisteve të përgjithshëm që do të kenë mundësi të punësohen në sektorë të ndryshëm dhe vecanërisht në ato që kanë lidhje me mesuesinë, mjedisin dhe natyrën.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:

1. Të kenë njohuritë e nevojshme shkencore në fushën e Biologjisë dhe të Kimisë.
2. Të jenë plotësisht të aftë të përfshihen në programe universitare të nivele me të larta si në ato Master në fushën e Mësuesisë, Mjedisit, Bioteknologjisë etj.
3. Të jenë të aftë të punësohen në sektorë të ndryshëm dhe vecanërisht në ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit dhe natyrës.
4. Të jenë të aftë të inkuadrohen në iniciativa dhe projekte lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit dhe natyrës.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit të përgjithshëm në fushën Biologjisë dhe Kimisë.

Objektivat e përmendura më lart që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë të lartë në fushën e aplikimit të njohurive të tyre shkencore biologjike dhe kimike në sektore të ndryshëm të shoqërisë apo dege të ndryshme të industrisë.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të Biologjisë, Kimisë, Mjedisit dhe Natyrës.

## VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm:** Fizikë në Biologji, Biologji qelizore, Histologji-Embriologji, Kimi e përgjithëshme, Anatomia normale e njeriut); **Kredite** 32,5.
2. **Lëndë të formimit karakterizues:** Zoologji pararuazore, Botanikë e përgjithëshme, Kimi inorganike, Kimi analitike, Zoologji vertebrorë, Sistematikë bimorë, Kimi inorganike, Kimi biologjike, Fiziologji bimorë, Kimi fizike dhe koloidale, Fiziologji shtazore, Gjenetikë, Mikrobiologji; **Kredite** 110.
3. **Lëndë integruese:** Biostatistikë, Biogeografi, Ekologji, Teori e evolucionit; **Kredite** 17.
4. **Lëndë me zgjedhje:** Entomologji, Paleontologji, Shkrim dhe menaxhim projekti, Etologji, Teknologji kimie, Virologji, Bioteknologji; **Kredite** 7.
5. **Lëndë të formimit plotësues:** Informatikë, Gjuhë e huaj; **Kredite** 8.
6. **Përgatitje punim diplome;** **Kredite** 5.5.

## SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 ( mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 ( mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

| NOTA        | PIKËT         |
|-------------|---------------|
| 4 (katër)   | 0 në 44 pikë  |
| 5 (pesë)    | 45 - 54 pikë  |
| 6 (gjashtë) | 55 - 64pikë   |
| 7 (shtatë)  | 65 - 74 pikë  |
| 8 (tetë)    | 75 – 84 pikë  |
| 9 (nëntë)   | 85 – 94 pikë  |
| 10 (dhjetë) | 95 – 100 pikë |

## MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma e Ciklit të Parë “Bachelor” në Biologji-Kimi është ura lidhëse e zhvillimit të mëtëjshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula e programit është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar mundësitë për specializime të mëtëjshme. Për këtë arsye objektivi më i rëndësishëm i programit është përgatitja e studentëve për tu përballur me kërkesat dhe mundësitë që ofron tregu të punës si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit “Bachelor” në Biologji-Kimi mundet të vazhdojë studimet në një program të Ciklit të Dytë në fushën e mësuesisë, biologjisë se mjedisit, biologjisë molekulare, bioteknologjisë molekulare dhe industriale apo në një fushë të ngjajshme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në Ciklin e Dytë , në programet :

1. Master në Mësuesi në AMU ne Biologji-Kimi
2. Master i Shkencave në Mësuesi në Biologji - Kimi

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime dhe specializime të mëtëjshme.

## **MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë dhe ekspertë të kualifikuar në fushat e biologjisë, kimisë, mbrojtjes së mjedisit dhe natyrës, me njohuri të thelluara shkencore për tju përgjigjur me sukses kërkesave të tregut të punës por edhe sfidave në fushën e kërkimit shkencor. Në këtë mënyrë, studentët e diplomuar në programin e studimit “Bachelor” mund të punësohen si:

1. Eksperte të pavarur për vlerësimin e mjedisit dhe të biodiversitetit
2. Ndihmës mësimorë pranë institucioneve të arsimit parauniversitar dhe universitar
3. Asistentë pranë institucioneve kërkimore-shkencore
4. Specialiste për hartimin e ligjshmërisë dhe politikave mjedisore pranë Bashkive.
5. Specialiste pranë OJQ apo Bashkive për zhvillimin e ekoturizmit
6. Laborantë në spitalet shtetërore dhe private
7. Specialiste pranë Agjensive Rajonale të Mjedisit
8. Specialistë pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU)
9. Specialistë në dege të ndryshme të industrisë së lehtë dhe ushqimore
10. Etj.

### DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor )

| Nr.                   | Lënda                       | ECTS | Orë gjithësej | Semestri |
|-----------------------|-----------------------------|------|---------------|----------|
| <b>Viti i parë</b>    |                             |      |               |          |
|                       | <b>LËNDË BAZË</b>           |      |               |          |
| 1.                    | Fizikë në Biologji          | 5    | 125           | Sem. I   |
| 2.                    | Biologji qelizore           | 5    | 125           | Sem. I   |
| 3.                    | Histologji - Embriologji    | 5    | 125           | Sem. II  |
| 4.                    | Kimi e përgjithëshme        | 12   | 300           | Sem.I,II |
|                       | <b>LËNDË KARAKTERIZUESE</b> |      |               |          |
| 5.                    | Zoologjipararruazore        | 14   | 350           | Sem.I,II |
| 6.                    | Botanikë e përgjithëshme    | 11   | 275           | Sem.I,II |
| 7.                    | <b>LËNDË PLOTËSUESE</b>     |      |               |          |
| 8.                    | Informatikë                 | 3    | 75            | Sem.I    |
| 9.                    | Gjuhë e huaj                | 5    | 125           | Sem.I,II |
| Gjithësej Viti i parë |                             | 60   | 1500          |          |

| Nr.                | Lënda                       | ECTS | Orë gjithësej | Semestri |
|--------------------|-----------------------------|------|---------------|----------|
| <b>Viti i dytë</b> |                             |      |               |          |
|                    | <b>LËNDË BAZË</b>           |      |               |          |
| 1.                 | Anatomi normale e njeriut   | 5.5  | 137.5         | Sem.I    |
|                    | <b>LËNDË KARAKTERIZUESE</b> |      |               |          |
| 2.                 | Kimi inorganike             | 5.5  | 137.5         | Sem.I    |
| 3.                 | Kimi analitike              | 5    | 125           | Sem.I,II |
| 4.                 | Zoologji vertebrorë         | 11   | 275           | Sem.I,II |
| 5.                 | Sistematikë bimorë          | 12   | 300           | Sem.II   |
| 6.                 | Kimi organike               | 9    | 225           | Sem.I,II |
| 7.                 | Kimi biologjike             | 5    | 125           | Sem.I    |
|                    | <b>LËNDË INTEGRUESE</b>     |      |               |          |
| 8.                 | Biosatitike                 | 4    | 100           | Sem.I    |
|                    | <b>LËNDË me ZGJEDHJE</b>    |      |               |          |
| 9.a                | Entomologji                 | 3    | 75            | Sem.I    |

|                       |                            |    |      |        |
|-----------------------|----------------------------|----|------|--------|
| 9.b                   | Palentologji               | 3  | 75   | Sem.II |
| 9.c                   | Shkrim e menaxhim projekti | 3  | 75   | Sem.II |
| Gjithësej Viti i dytë |                            | 60 | 1500 |        |

| Nr.                                      | Lënda                           | ECTS       | Orë gjithësej | Semestri |
|------------------------------------------|---------------------------------|------------|---------------|----------|
| <b>Viti i tretë</b>                      |                                 |            |               |          |
|                                          | <b>LËNDËKARAKTERIZUESE</b>      |            |               |          |
| 1.                                       | Fiziologji bimore               | 8.5        | 212.5         | Sem.I,II |
| 2.                                       | Kimi fizike e koloidale         | 8          | 200           | Sem.I,II |
| 3.                                       | Fiziologji shtazore             | 8.5        | 212.5         | Sem.I,II |
| 4.                                       | Gjenetikë                       | 8.5        | 212.5         | Sem.I,II |
| 5.                                       | Mikrobiologji                   | 4          | 100           | Sem.II   |
|                                          | <b>LËNDË INTEGRUESE</b>         |            |               |          |
| 6.                                       | Biogjeografi                    | 4          | 100           | Sem.II   |
| 7.                                       | Ekologji                        | 5.5        | 137.5         | Sem.I    |
| 8.                                       | Teori evolucioni                | 3.5        | 87.5          | Sem.II   |
|                                          | <b>LËNDË ME ZGJEDHJE</b>        |            |               |          |
| 9.a                                      | Etologji                        | 2          | 50            | Sem.II   |
| 9.b                                      | Teknologji kimie                | 2          | 50            | Sem.II   |
| 10.a                                     | Virologji                       | 2          | 50            | Sem.I    |
| 10.b                                     | Bioteknologji                   | 2          | 50            | Sem.I    |
| 11.                                      | <b>PËRGATITJE PUNIM DIPLOME</b> | 5.5        | 137.5         | Sem.II   |
| Gjithësej Viti i tretë                   |                                 | 60         | 1500          |          |
| <b>Totali Viti i I +Viti II+Viti III</b> |                                 | <b>180</b> | <b>4500</b>   |          |